



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtri



Bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2 shkronja “d” të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale nenin 19, paragrafi 1.3 të Statutit të komunës, si dhe Strategjia p137r avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026.Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më **28 mars 2024** miraton këtë:

PLANI
LOKAL I VEPRIMIT PËR AVANSIMIN E TË DREJTAVE TË
KOMUNITETEVE ROM DHE ASHKALI NË KOMUNËN E
VUSHTRRISË
2024-2026

Mars, 2024

Përmbajtja

SHKURTESAT	3
1. HYRJE	4
1.1. Metodologjia	4
2. ANALIZA E GJENDJES.....	5
2.1. Arsimi.....	5
2.2. Punësimi dhe mirëqenia sociale	6
2.3. Shëndetësia.....	7
2.4. Banimi	8
2.5. Diskriminimi.....	12
3. OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETET	9
3.1. Arsimi.....	10
3.1.1. Rezultatet e pritshme.....	103
3.1.2. Përshkrimi i aktiviteteve	114
3.1.3. Supozimet dhe rreziqet.....	16
3.2. Punësimi dhe mirëqenia sociale	17
3.2.1. Rezultatet e pritshme.....	147
3.2.2. Përshkrimi i aktiviteteve	18
3.2.3. Supozimet dhe rreziqet.....	20
3.3. Shëndetësia.....	21
3.3.1. Rezultatet e pritshme.....	18
3.3.2. Përshkrimi i aktiviteteve	21
3.3.3. Supozimet dhe rreziqet.....	19
3.4. Banimi	203
3.4.1. Rezultatet e pritshme.....	20
3.4.2. Përshkrimi i aktiviteteve	20
3.4.3. Supozimet dhe rreziqet.....	214
3.5. Diskriminimi.....	25
3.4.1. Rezultatet e pritshme.....	25
3.4.2. Përshkrimi i aktiviteteve	205
3.4.3. Supozimet dhe rreziqet.....	216
4. BUXHETI.....	23
5. PLANI I ZBATIMIT	25

SHKURTESAT

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
DSH	Drejtoria e Shëndetësisë
DMS	Drejtoria e Mirëqenies Sociale
IP	Institucionet Parashkollore
MAShT	Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
MSh	Ministria e Shëndetësisë
OSHC	Organizatrat e Shoqërisë Civile
PLV	Plani Lokal i Veprimit
PRTAN	Ekipet për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
QM	Qendra Mësimore
QMF	Qendra e Mjekësisë Familjare
QPS	Qendra për Punë Sociale
QAP	Qendra e Aftësisimit Profesional
IKAP	Institucioni i Kosovës për Administratë Publike
SISH	Sistemi i informimit shëndetësor
SMIA	Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim
SËOT	Fuqite, Dobësitë, Mundësitë dhe Rreziqet
ZP	Zyra e Punësimit
ZKKK	Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim
ZQM	Zyra për Qeverisje të Mirë
ZK	Zyra e Kryeministrit
KKV	Komiteti Komunal Veprues

1. HYRJE

Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM/ZKM) pranë Zyrës së Kryeministrit, ndërmori iniciativën për hartimin e Strategjisë së re për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom, ashkali në Republikën e Kosovës. Pas një procesi të gjatë gjithëpërfshirës dhe konsultimesh me të gjithë aktorët, në korrik të vitit 2022, është aprovuar Strategjia për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026.

Komuna e Vushtrrisë sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 2011 ka 69870 banorë. Sipërfaqja e Komunës së Vushtrrisë është rreth 345 km² dhe ka 67 vendbanime.

Sipas statistikave të vitit 2023, nga Zyra komunale për komunitete dhe kthim (ZKKK) në Komunën e Vushtrrise jetojnë 77 familje të komuniteteve rom dhe ashkali, me gjithsej 311 anëtarë. komuniteti rom, ashkali kryesisht jetojnë në zonën rurale dhe urbane.

Për të adresuar problemet dhe sfidat me të cilat ballafaqohen komunitetet rom dhe ashkali , Komuna e Vushtrrise, ka iniciuar procesin e hartimit të Planit lokal të veprimit për avancimin e komuniteteve rom dhe ashkali.

Për realizimin e këtij Plani lokal të veprimit, Komuna e Vushtrrise ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për themelimin e Komitetit Komunal Veprues.

1.1. Metodologjia

Komuna e Vushtrrisë ka formuar Komitetin Komunal Veprues. Jane zhvilluar takime dhe konsultime për nevojën e hartimit të PVL, është formuar grupi punues dhe është hartuar plani i punës i cili përfshinë dinamikën e draftit dokumentit, konsultimet publike deri në miratim nga Kuvendi i Komunës.

Bazuar në Strategjinë për avancimin e komuniteteve rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026. Ka identifikuar pesë fusha kryesore, të cilat edhe KKV ka vendosur që Plani lokal i Veprimit për avancimin e komuniteteve rom dhe ashkali në Komunën e Vushtrrisë të ketë këto pesë fusha kryesore:

1. Arsimi,
2. Punësimi dhe përkujdesja sociale,
3. Shëndetësia,
4. Banimi,
5. Diskriminimi.

2. ANALIZA E GJENDJES

Bazuar ne vlersimin nga Zyra komunale për komunitete dhe kthim – ZKKK në komunën e Vushtrrisë jetojnë 89 familje të komuniteteve rom dhe ashkali, me gjithsej 583 anëtarë. 26 familje i përkasin komunitetit ashkali, përkatësisht 97 anëtarë, 55 familje të komunitetit rom, përkatësisht 320 anëtarë.

Sipas evidencave të ZKKK-së numri i nxënësve të përfshirë në arsimin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, janë të përfshirë 120 fëmijë.

Numri i familjeve të komunitetit rom,ashkali që janë në asistencë sociale në komunëne e Vushtrrisë është 51 familje me 214 anëtarë.

2.1. Arsimi

Në Komunën e Vushtrrisë, përfshirja e fëmijëve të komuniteteve rom dhe ashkali në të gjitha nivelet e arsimit , mbetet në nivel jo të kënaqshëm.

Komuna e Vushtrrisë ofrone mbështetje për nxënësit e komunitetit rom sidomos ne edukimin jo formal duke mos pasur mundesi që nje mbeshtetje e tille te behet ne kuader te sitemit arsimor te Republikës së Kosovës, ndërsa fëmijët e komunitetit ashkali jane te perfshire në sistemin arsimor të Republikës së Kosovës.

Analiza SËOT paraqet gjendjen aktuale të arsimit të komuniteteve rom dhe ashkali në Komunën e Vushtrrisë.

Tabela e analizës SËOT në fushën e Arsimit

Fuqite / pikat e forta	Dobesite
<ul style="list-style-type: none">• Institucionet arsimore komunale me kapacitete te plota per zhvillimin e arsimit• Infrastrukturë dhe hapësira komunale të mjaftueshme për zhvillimin e procesit edukativo arsimor,• Baze e mjaftueshme ligjore per zhvillimin e procesit edukativo arsimor	<ul style="list-style-type: none">• Mungesa e fushatave informuese për mundësitë e vazhdimit të shkollimit• Vetëdijësimi i ulët i prindërve të komuniteteve për rëndësinë e shkollimit• Mosvazhdimi i shkollimit të mesëm të lartë nga komuniteti rom dhe ashkali• Mungese e kuadrit adekuat nga vete komuniteti rom dhe ashkali
Mundesite	Rreziqet

<ul style="list-style-type: none"> • Bashkëpunim i shtuar në mes Ekipeve për mosbraktisje të shkollës • Ndarja e bursave për student të komuniteteve rom dhe ashkali me kritere afirmative • Ndarja e mjeteve financiare / sumvencionim për zhvillimin e edukimit jo formal • Bshkëpunimi me shoqerine civile dhe donatoret për edukimin jo formal të komuniteteve rom dhe ashkali 	<ul style="list-style-type: none"> • Ndikim i strukturave paralele me ndikim për mos perfshirje në sitemin arsimor të Republikës së Kosovës • Martesat e hershme • Ndërprerja e shkollimit për shkak të kushteve socio - ekonomike • Puna e detyrueshme në moshe të hershme.
--	--

2.2. Punësimi dhe mirëqenia sociale

Papunësia në Kosovë sipas të dhënave të fundit nga Agjencia e Statistikave të Kosovës është 25.9 %. Raportet e fundit të publikuar nga ASK dhe nga hulumtime të ndryshme, tregojnë se shkalla e papunësisë të komunitetet rom dhe ashkali është shumë më e madhe sesa vlerat në nivel vendi.

Statistikat nga ZKKK-ja tregojnë se gjatë vitit 2017, në institucione publike dhe private janë të punësuar 18 ashkali. Megjithatë, ekziston një diferencë e lartë në mes të numrit të të punësuarve nga komunitetet dhe punëkërkesve.

Niveli i lartë i papunësisë së pjesëtarëve të komuniteteve ka ndikuar drejtpërdrejt edhe në mirëqenien sociale të tyre. Numri i familjeve të komuniteteve rom dhe ashkali që janë përfitues të asistencës sociale është 49 dhe rreth 91 familje që kanë gjendje jo të mirë ekonomike.

Analiza SWOT paraqet gjendjen aktuale në fushën e punësimit dhe perkujdesjes sociale të komuniteteve rom dhe ashkali në Komunën e Vushtrrisë.

Tabela e Analizës SWOT në fushën e punësimit dhe të mirëqenies sociale

Fuqite	Dobesite
<ul style="list-style-type: none"> • Rritja e kekeses për fuqi punetore • Kapacitete institucionale për aftësim profesional • Baze e mjaftueshme ligjore për mundësi të punësimit • Asistenca sociale • Ofrimi i pakove të ndihmave nga Komuna për familjet në nevojë 	<ul style="list-style-type: none"> • Numri jo i mjaftueshem i ofrimit të trajnimeve për punë • Mungesa e koordinimit të Zyrës së Punësimit me organet tjera komunale • Mosndarja e disa programeve të veçanta për avancimin e komuniteteve • Mundësi të kufizuara për punësim • Mungesa e kuadrove profesionale

<ul style="list-style-type: none"> Fushata për regjistrim civil falas gjatë muajit prill 	<ul style="list-style-type: none"> Mungesa e buxhetit për shërbimet sociale
Mundesite	Rreziqet
<ul style="list-style-type: none"> Përgatitja e kuadrove për punësim Ndjekja e kurseve QAP Bashkëpunim të shtuar me Zyrën e Punësimin dhe QAP Perfshirja në punë praktike në institucionet publike dhe biznese 	<ul style="list-style-type: none"> Kapacitete të limituara të institucioneve për ofrim të shërbimeve të nevojshme Mos zbatimi i Ligjit të punës Mungesa e fondeve për ofrimin e trajnimeve të vazhdueshme në QAP Mos-planifikimi familjar Shtimi i numrit të rasteve sociale Varësia nga ndihmat

2.3. Shëndetësia

Shërbimet shëndetësore në komunën e Vushtrrisë kanë një shtrirje të gjerë dhe mbulojnë mjaft mirë të gjithë territorin e komunës. Drejtoria e Shëndetësisë ka bërë avancime shumë të mira përse i përket kushteve në QMF dhe kualitetit të shërbimeve

Analiza SËOT paraqet gjendjen aktuale në fushën e shëndetësisë të komuniteteve rom dhe ashkali në Komunën e Vushtrrisë.

Tabela e Analizës SWOT në fushën e Shëndetësisë

Fuqite	Dobesite
<ul style="list-style-type: none"> Kapacitete të mjaftueshme për ofrimin e shërbimeve shëndetësore Organizimi i fushatave vetëdijësuese për shëndetin, Qasje e lehtë në shërbimet primare të shëndetësisë Ofrimi i shërbimeve shëndetësore falas për kategoritë e caktuara Vizita shëndetësore në shtëpi dhe shkollë 	<ul style="list-style-type: none"> Mungesa e barnave nga lista esenciale Mungesa e SISH (Sistemi i Informimit Shëndetësor) për të siguruar informata të sakta për gjendjen shëndetësore Niveli jo i kënaqshëm i vaksinimit të fëmijëve nga komunitetet Edukimi i pamjaftueshëm shëndetësor
Mundesite	Rreziqet
<ul style="list-style-type: none"> Organizimi i fushatave vetëdijësuese për përmirësimin e edukimit shëndetësor Ofrimi i shërbimeve shëndetësore në të gjitha institucionet lokale shëndetësore pa dallim 	<ul style="list-style-type: none"> Mungesë buxheti për rastet urgjente Përhapja e sëmundjeve ngjitëse dhe epidemive

<ul style="list-style-type: none"> • Lirimi nga pagesa për familjet në nevojë • Sigurimi i barnave esenciale • Organizimi i kontrollove sistematike për femra (rastet e kancerit të gjirit) 	
--	--

2.4. Banimi

Gjendja në Komunën e Vushtrisë përsa i përket çështjes së banimit për komunitetet rom dhe ashkali, është përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme. Megjithatë, një numër i familjeve kanë probleme me kushte të vështira të banimit, kanë mungesë të pronave për ndërtim të shtëpive, kanë probleme me dokumentacion të pronës.

Analiza SËOT ka nxjerrë edhe disa të dhëna të tjera që janë të pasqyruara në tabelën e mëposhtme.

Tabela e Analizës SËOT në fushën e Banimit

Fuqite	Dobesite
<ul style="list-style-type: none"> • Mundesi e pageses per qera te banimit • Rregullimi i infrastrukturës përcjellëse në lagjet ku jetojnë komunitetet • Planifikimi per shurjen e vendbanimeve jo formale 	<ul style="list-style-type: none"> • Mjete te pa mjaftueshme per pagaesa te qirasë • Buxheti i pamjaftueshëm • Mungese planifikimi te lagjeve formale
Mundesite	Rreziqet
<ul style="list-style-type: none"> • Ndërtimi i shtëpive të reja me ndihmën e donatorëve • Renovimi i shtëpive • Rregullimi i infrastruktures sipas prioriteteve 	<ul style="list-style-type: none"> • Migrimi për shkak të mungesë së banimit • Mosrenovimi i shtëpive të vjetra • Ndërtimi i shtëpive në ambiente jo të banueshme

2.5. Diskriminimi

Diskriminimi është prezent në gjithë popullatën, sidomos në aspektin gjinor, por tek komuniteti rom dhe ashkali është më shumë prezent për shkak të përkatësisë së tyre etnike.

Diskriminimi, është një fenomen që është prezent në fushën e arsimit, punësimit dhe mirëqenies sociale, shëndetësisë dhe banimit.

Tabela e Analizës SWOT në fushën e Diskriminimit

Fuqite	Dobesite
<ul style="list-style-type: none"> • Infrastruktura ligjore ne mbrojtjen ndaj diskriminimit ne pergjithesi • Mekanizma lokal per mbrojtjen ndaj diskriminimit • Rritja e llogaridhënjes dhe ndëshkimit ndaj ushtruesve të diskriminimit 	<ul style="list-style-type: none"> • Mekanizma jo aktiv ne mbrojtjen dhe prmovimin kunder diskriminimit • Buxheti i pamjaftueshëm • Mungese e kapaciteteve trajnuese dhe programeve per mbrojtjen ndaj diskriminimit
Mundesite	Rreziqet
<ul style="list-style-type: none"> • Forcim i mekanizmave institucional ne mbrojtjen ndaj diskriminimit • Trajnime të vazhdueshme profesionale për zyrtarë publikë kundër diskriminimit • Ngritja e kapaciteteve profesionale në luftimin dhe parandalimin e diskriminimit • Fushata ndërgjegjësuese për dhunën në familje dhe në baza gjinore 	<ul style="list-style-type: none"> • Mos integrimi ne shoqeri • Rritja dhunes dhe veprimve devijante • Migrimi jashte vendit

3. OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETET

Siç është paraqitur në analizën e gjendjes, ky Plan i veprimit do t'i ketë 5 fusha kryesore të bazuara edhe në Strategjinë për avancimin e komuniteteve rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës.

Për secilën nga këto fusha është përcaktuar një objektiv strategjik, ndërsa për çdo objektiv janë përcaktuar rezultatet të cilat do të arrihen duke i zbatuar aktivitetet specifike.

Më poshtë do të paraqiten objektivat strategjike, rezultatet dhe aktivitetet për secilën fushëveprim të Planit të veprimit.

3.1. Arsimi

Ndryshimet në fushën e arsimit janë të domosdoshme për të siguruar një shoqëri kohezive dhe gjithëpërfshirëse. Ky Plan i veprimit parasheh disa aktivitete që do të përmirësojnë arsimin për komunitetet rom dhe ashkali.

Objektivi strategjik 1

Për të siguruar avancimin dhe rezultate të mira në fushën e arsimit është përcaktuar ky objektivi strategjik:

Objektivi 1: Rritja dhe ofrimi i qasjes së barabartë dhe mbarëvajtjes në arsim cilësor gjithëpërfshirës për komunitetet rom dhe ashkali.

3.1.1. Rezultatet e pritshme

Për përmbushjen e objektivit strategjik të përcaktuar në këtë Plan veprimi për fushën e arsimit parashihet arritja e rezultateve si në vijim:

- **Rezultati 1.1.** Përmirësohet pjesëmarrja në arsimin parafillor të fëmijëve të komuniteteve rom dhe ashkali ;
- **Rezultati 1.2.** Përmirësohet pjesëmarrja në arsim fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, të fëmijëve të komuniteteve rom dhe ashkali;
- **Rezultati 1.3.** Përmirësohet performanca e nxënësve dhe studentëve të komuniteteve rom dhe ashkali .

3.1.2. Përshkrimi i aktiviteteve

REZULTATI 1.1:	Përmirësohet pjesëmarrja në arsimin parafillor të fëmijëve të komuniteteve rom dhe ashkali
AKTIVITETI	PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT
Aktiviteti 1.1.1 Organizimi i fushatave vetëdijësuese për regjistrim në edukimin parafillor	<p>ZKKK në bashkëpunim me DKA-në dhe shkollat ku frekuentojnë nxënësit nga komunitetet rom dhe ashkali, për çdo fillimvit shkollor organizon fushatë vetëdijësuese për regjistrim në edukimin parafillor të fëmijëve nga komunitetet rom dhe ashkali.</p> <p>Fushata vetëdijësuese përfshin organizimin e takimeve individuale me familjet e komuniteteve; shpërndarje të informatave për regjistrim. Fushatat organizohen nga shkollat, derisa ZKKK dhe DKA ofrojnë përkrahje për shkollat.</p>
Aktiviteti 1.1.2 Subvencionimi i pagesave të çerdhes për rritjen e përfshirjes së komuniteteve rom dhe ashkali	<p>DKA, ZKKK në bashkëpunim me MASHT dhe OJQ do të bëjnë identifikimin e gjithë fëmijëve që mund të regjistrohen në qerdhe dhe DKA/MASHT do të subvencionojnë shkollimin e tyre parafillor.</p> <p>Ky aktivitet ka qëllim zvogëlimin e hendekut në pjesëmarrjen e arsimit parashkollor ndërmjet fëmijëve rom dhe ashkali në komunën e Vushtrrisë .</p>
REZULTATI 1.2:	Përmirësohet pjesëmarrja në arsimin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, të fëmijëve të komuniteteve rom dhe ashkali
AKTIVITETI	PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT
Aktiviteti 1.2.1 Organizimi i fushatave vetëdijësuese për regjistrim në edukimin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë	<p>ZKKK në bashkëpunim me DKA-në dhe shkollat ku frekuentojnë nxënësit nga komunitetet rom dhe ashkali, për çdo fillimvit shkollor organizon fushatë vetëdijësuese për regjistrim në edukimin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë të fëmijëve nga komunitetet rom dhe ashkali.</p> <p>Fushata vetëdijësuese përfshin organizimin e takimeve individuale me familjet e komuniteteve; shpërndarje të informatave për regjistrim. Fushatat organizohen nga shkollat, derisa ZKKK dhe DKA ofrojnë përkrahje për shkollat.</p>

<p>Aktiviteti 1.2.2 Identifikimi i fëmijëve në nevojë dhe sigurimi i mjeteve arsimore</p>	<p>ZKKK në bashkëpunim me DKA dhe QPS, bëjnë identifikimin e familjeve që kanë gjendje të rëndë ekonomike dhe që kanë fëmijë të moshës së arsimit të detyruar. Fëmijët e identifikuar duhet të pajisen me tekste shkollore së paku një herë në vit.</p> <p>Përveç përkrahjes me tekste shkollore nga Komuna, institucionet përgjegjëse mund të kërkojë edhe ndihmën e donatorëve dhe të bizneseve private për t'i përkrahur këta nxënës me materiale shkollore dhe kushte tjera të mundshme.</p>
<p>Aktiviteti 1.2.3 Adresohen rastet e braktisjes dhe fëmijëve të riatdhesuar</p>	<p>ZKKK në bashkëpunim me sektorët tjerë në nivel komune, identifikon të gjithë fëmijët që kanë braktisur shkollimin dhe familjet e ri-atdhesuara të cilat kanë fëmijë të moshës shkollore. Pas identifikimit, ZKKK ndërmerret të gjithë hapat për të adresuar në mënyrën më të mirë nevojat e këtyre familjeve.</p> <p>Në rastet e braktisjes, ZKKK dhe DKA aktivizojnë të gjithë mekanizmat për të siguruar vijimin e shkollimit nga nxënësit braktisës.</p> <p>Për rastet e fëmijëve të riatdhesuar, ZKKK krahas përkrahjes që ofron në kuadër të politikave të riatdhesimit, do të ofrojë edhe përkrahje shtesë për fëmijët e moshës shkollore, p.sh. përkrahje për t'u pajisur me dokumentacionin përkatës, përkrahje për të nostrifikuar dokumentet.</p>
<p>REZULTATI 1.3:</p>	<p>Përmirësohet performanca e nxënësve dhe studentëve të komuniteteve rom dhe ashkali</p>
<p>AKTIVITETI</p>	<p>PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT</p>
<p>Aktiviteti 1.3.1. Organizohet mësimi plotësues dhe shtesë për fëmijët e komuniteteve rom dhe ashkali</p>	<p>DKA në bashkëpunim me ZKKK dhe OJQ-të, organizojnë mësim plotësues dhe shtesë për fëmijët nga komunitetet rom dhe ashkali që kanë rezultate të ulëta të të nxënësve. Bartës kryesor për organizimin e mësimin shtesë mund të jenë OJQ-të, derisa DKA, shkollat dhe ZKKK ofrojnë mbështetje organizative dhe në mobilizimin e donatorëve.</p>
<p>Aktiviteti 1.3.2. Organizohet arsimimi jo-formal për fëmijët që kanë vonesa në shkollimin e obliguar</p>	<p>DKA, ZKKK dhe shkollat në bashkëpunim me MASHT dhe OJQ-të, do të bëjnë identifikimin e të gjithë fëmijëve që kanë vonesa në shkollimin e obliguar.</p> <p>edukimi jo-formal do të aplikohet gjatë viteve të zbatimit të këtij Plani të veprimit, me qëllim të përfshirjes së të gjithë fëmijëve. Megjithatë, do të maksimizohen mundësitë që rastet që kanë mundësi, të përfshihen në sistemin e rregullt shkollor.</p>

<p>Aktiviteti 1.3.3. Organizimi i trajnimeve kundër diskriminimit dhe paragjykimeve për mësimdhënës</p>	<p>DKA në bashkëpunim me donatorët dhe me OSHC-të që ofrojnë trajnime të kësaj natyre, organizojnë trajnime periodike kundër diskriminimit dhe paragjykimeve për mësimdhënësit që punojnë me fëmijë të komuniteteve rom dhe ashkali.</p>
<p>Aktiviteti 1.3.4. Monitorimi i suksesit dhe qëndrueshmëria e intervenimit</p>	<p>ZKKK në bashkëpunim me DKA dhe me shkollat monitorojnë suksesin e fëmijëve të komuniteteve rom dhe ashkali, të cilët janë përfitues të skemave të ndryshme përkrahëse (përfituesit e bursave, përfituesit e pakove shkollore, përfituesit e mësimintenziv). Hartohet një raport i cili shpërndahet tek sektorët përgjegjës.</p>

3.1.3. Supozimet dhe rreziqet

Supozimet kryesore për të siguruar arritjen e Objektivit 1, të paraparë me këtë dokument, janë:

- Të gjitha palët e përfshira kanë vullnet dhe angazhohen për rritjen e nivelit të përfshirjes, zvogëlimin e rasteve të braktisjeve të shkollimit dhe përmirësimin e suksesit të nxënësve të komuniteteve rom dhe ashkali në arsimin parauniversitar, duke i realizuar aktivitetet e parapara me këtë dokument;
- MASHT tregon përkushtim për përfshirjen në mësim intenziv të fëmijëve nga komunitetet rom dhe ashkali që kanë vonesa në shkollimin e obliguar;
- Mësimdhënësit e trajnuar do të zbatojnë metoda dhe teknika në procesin mësimor për të siguruar një ambient mik për të gjithë fëmijët, pa dallime.

Ndërkaq, faktorët që mund ta rrezikojnë arritjen e Objektivit 1, të paraparë me këtë dokument, janë:

- Mosgatishmëria e shkollave për të zbatuar politikën anti-diskriminuese;
- Mungesa e buxhetit nga MASHT për përkrahje të mësimintenziv;
- Mosgatishmëria e komunitetit për të bashkëpunuar me institucionet për të adresuar problemet e përfshirjes në arsim.

3.2. Punësimi dhe mirëqenia sociale

Gjatë punës për hartimin e këtij Plani të veprimit është konstatuar se përmirësimet në këtë fushë do të kenë ndikim shumë të madh në përmirësimin e mirëqenies sociale, do të motivojnë të rinjtë që t'i kushtojnë më shumë rëndësi shkollimit, rrjedhimisht, shumë probleme të identifikuara në kuadër të këtij Plani do të adresoheshin apo zgjidheshin.

Marrë parasysh rëndësinë që kanë intervenimet në këtë fushë, punësimi dhe mirëqenia sociale është përmbledhur në një objektiv strategjik të Planit, që parasheh ndërmarrjen e disa

veprimeve që do të ndikonin në përmirësimin e gjendjes ekonomike-sociale të komuniteteve rom dhe ashkali.

Objektivi strategjik 2

Në fushën e punësimit dhe mirëqenies sociale është përcaktuar ky objektivi strategjik:

Objektivi 2: Rritja e qasjes së barabartë në punësim të qëndrueshëm, si dhe ulja e varfërisë të komuniteteve rom dhe ashkali.

3.2.1. Rezultatet e pritshme

Për përmbushjen e objektivit strategjik të përcaktuar në këtë Plan veprimi për fushën e punësimit dhe mirëqenies sociale, parashihet arritja e rezultateve si në vijim:

- **Rezultati 2.1.** Përmirësimi i qasjes në pjesëmarrje të barabartë në treg të punës përmes sistemit të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali në zyrat komunale për punësim dhe programeve të aftësimin profesional;
- **Rezultati 2.2.** Rritja e pjesëmarrjes dhe mundësive në punësim, përmes senzibilizimit të punëdhënësve dhe pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali si dhe masave stimuluese për punëdhënës;
- **Rezultati 2.3.** Përfshirja e komuniteteve rom dhe ashkali në punësim në institucione publike lokale, sipas kuotave të përcaktuara me ligj.

3.2.2. Përshkrimi i aktiviteteve

REZULTATI 2.1:	Përmirësimi i qasjes në pjesëmarrje të barabartë në treg të punës përmes sistemimit të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali në zyrat komunale për punësim dhe programeve të aftësimi profesional
AKTIVITETI	PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT
Aktiviteti 2.1.1 Identifikimi i fuqisë punëtore nga komunitetet rom dhe ashkali dhe ofrimi i këshillave për punësim	ZKKK në bashkëpunim me Zyrën e Punësimit bën identifikimin e fuqisë punëtore nga komunitetet rom dhe ashkali (i të papunëve dhe punëkërkesve). Në bazë të nevojës harton plane përkrahëse këshilluese. ZKKK ndërmjetëson në raste të ndryshme, me qëllim të rritjes së punësimit të përfaqësuesve të komuniteteve.
Aktiviteti 2.1.2 Ofrimi i trajnimeve profesionale nga QAP për punëkërkesit	ZKKK në bashkëpunim me Zyrën e Punësimit dhe në koordinim të ngushtë me Qendrat për Aftësim Profesional, duke u bazuar në nevojat e punëkërkesve nga komunitetet rom dhe ashkali, harton plane për përfshirjen në trajnime për aftësim profesional. Organizimi i trajnimeve mund të bëhet duke i përfshirë përfituesit potencialë në programe të ndryshme që janë duke u zbatuar nga USAID, GIZ etj.
Aktiviteti 2.1.3 Monitorimi i rasteve të dhunës së grave dhe fëmijëve në familje, në strehimoren rehabilituese	ZKKK në bashkëpunim me Zyrën e Punësimit, OJQ-të monitorojnë dhe raportojnë në vazhdimësi tek autoritet për rastet e viktimave të dhunës në familje.
Aktiviteti 2.1.4 Identifikimi i familjeve që janë në asistencë sociale, dhe familjeve të cenueshme, ofrimi i ndihmave me pako ushqimore dhe higjienike	ZKKK në bashkëpunim me QPS-të do të bëjë identifikimin e familjeve me asistencë sociale, ZKKK do të shpërndajë pako me material ushqimorë dhe higjienik për këto familje.

REZULTATI 2.2:	Rritja e pjesëmarrjes dhe mundësive në punësim përmes senzibilizimit të punëdhënësve dhe pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali, si dhe masave stimuluese për punëdhënës.
AKTIVITETI	PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT
Aktiviteti 2.2.1 Subvencionimi i bizneseve private për stimulim të punësimit të komuniteteve	<p>ZKKK në bashkëpunim me Zyrën e Punësimit, identifikon bizneset private që janë duke kërkuar fuqi punëtore. Në bashkëpunim me secilin biznes (aty ku ka gatishmëri dhe interesim) hartohet plani për punësimin e punëkërkuësve nga komunitetet. Ky plan parasheh edhe subvencionimin nga ana e Komunës / ZKKK për biznesin.</p> <p>ZKKK duhet të luaj rol koordinues në zbatimin e këtij aktiviteti përmes bashkërendimit të punëve me të gjitha drejtoritë përkatëse të Komunës, ZQM, ministritë e linjës dhe komunitetin e donatorëve.</p>
Aktiviteti 2.2.2 Parandalimi i punëve të rënda dhe mbrojtja e fëmijëve të komuniteteve rom dhe ashkali	<p>Rastet e shumta të shfrytëzimit të fëmijëve qoftë për punë të rënda apo edhe shfrytëzimit të tyre për të kërkuar lëmshë, obligojnë institucionet lokale që të zbatojnë masa për parandalimin e keqpërdorimit të fëmijëve.</p> <p>ZKKK do të ketë rol monitorues dhe mobilizues për të njoftuar institucionet dhe mekanizmat tjerë, në mënyrë që të parandalohet çdo keqpërdorim i fëmijëve të komuniteteve qoftë nga familja, apo grupet tjera të interesit.</p>
Aktiviteti 2.2.3 Koordinim i shtuar në mes sektorëve komunal për të avancuar qasjen e pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali në punësim dhe shërbime sociale	<p>ZKKK do të themelojë një mekanizëm komunal ndërsektorial që do të ketë për mandat koordinimin e të gjithë akterëve për të avancuar qasjen e pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali në punësim.</p> <p>Në këtë mekanizëm do të bëjnë pjesë: ZKKK (koordinator), DSH, DMS, QPS, Zyra e punësimit, DKA, OJQ-të, bizneset etj. Varësisht nga nevojat, ky mekanizëm mund të zgjerohet edhe me përfaqësues nga palët me interes.</p>
Aktiviteti 2.2.4 Organizim i takimeve periodike për koordinim në mes të sektorëve	<p>ZKKK si koordinatore e Grupit koordinues, do të organizojë takime periodike për të siguruar ndërmarrjen e të gjithë hapave të nevojshëm për të avancuar qasjen e pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali në punësim dhe shërbime sociale.</p>
REZULTATI 2.3:	Përfshirja e komuniteteve rom dhe ashkali në punësim në institucione publike qendrore dhe lokale, sipas kuotave të përcaktuara me ligj.

AKTIVITETI	PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT
Aktiviteti 2.2.1 Fushatë informuese dhe avokuese për respektim të kuotës së punësimit për komunitetet	<p>ZKKK në bashkëpunim me Zyrën e Punësimit, dhe me përkrahjen e OSHC-ve dhe donatorëve të ndryshëm, organizojnë fushatë avokuese në nivel komunal për të avancuar zbatimin e kuotës së punësimit për komunitetet rom dhe ashkali.</p> <p>Kjo fushatë do të koordinohet nga ZKKK dhe ka për qëllim informimin e të gjitha institucioneve në nivel komune, bizneseve, punëdhënësve potencialë, por edhe publikut në përgjithësi për kuotat e përcaktuara me ligj për punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve.</p>

3.2.3. Supozimet dhe rreziqet

Supozimet kryesore për të siguruar arritjen e Objektivit 2 të paraparë me këtë dokument, janë:

- Të gjitha palët e përfshira kanë vullnet dhe angazhohen për realizimin e aktiviteteve të parapara me këtë dokument;
- Bizneset tregojnë gatishmëri për të punësuar pjesëtarë nga komunitetet rom dhe ashkali.

Ndërkaq, faktorët që mund ta rrezikojnë arritjen e Objektivit 2 të paraparë me këtë dokument, janë:

- Mungesa e angazhimit dhe përkushtimit të palëve të përfshira për të marrë përgjegjësitë që dalin nga ky Plan;
- Mungesa e bashkëpunimit nga bizneset përfituese të subvencioneve;
- Mungesa e bashkëpunimit nga vetë pjesëtarët e komuniteteve.

3.3. Shëndetësia

Edhe përkundër shumë intervenimeve që janë bërë në përmirësimin e shëndetit të komuniteteve rom dhe ashkali në komunën e Vushtrrisë, ka nevojë të intervenohet në disa aspekte.

Marrë parasysh rëndësinë që kanë intervenimet në këtë fushë, ky Plan parashih ndërmarrjen e disa veprimeve që do të ndikonin në përmirësimin e gjendjes së shëndetit të komuniteteve rom dhe ashkali.

Objektivi strategjik 3

Në fushën e shëndetësisë është përcaktuar ky objektivi strategjik:

Objektivi 3: Përmirësimi i shëndetit të pjesëtarëve të komunitetit rom dhe ashkali dhe rritja e qasjes së barabartë në shërbime cilësore shëndetësore.

3.3.1. Rezultatet e pritshme

Për përmbushjen e objektivit strategjik të përcaktuar në këtë Plan veprimi për fushën e shëndetësisë, parashihet arritja e rezultateve të pritshme në vijim:

- **Rezultati 3.1.** Përmirësohet qasja në shërbime shëndetësore cilësore për komunitetet rom dhe ashkali;
- **Rezultati 3.2.** Përmirësimi i shëndetit të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali përmes ndërgjegjësimit dhe promovimit të shëndetit;
- **Rezultati 3.3** Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore, përmes ndërgjegjësimit të stafit shëndetësor publik për trajtim të barabartë dhe eliminim të diskriminimit të komuniteteve rom dhe ashkali.

3.3.2. Përshkrimi i aktiviteteve

REZULTATI 3.1:	Përmirësohet qasja në shërbime shëndetësore për komunitetet rom dhe ashkali
AKTIVITETI	PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT
<p>Aktiviteti 3.1.1 Organizimi i vizitave periodike shëndetësore në familjet e komuniteteve nga QKMF</p>	<p>Rritja e besueshmërisë së familjeve të komuniteteve, veçmas fëmijëve, në raport me institucionet shëndetësore dhe familjarizimi me to, do të ndikonte në ngritjen e vetëdijes së pjesëtarëve të komuniteteve për të shfrytëzuar këto shërbime.</p> <p>QKMF me përkrahjen e DSHMS dhe ZKKK, organizon vizita periodike në familjet e komuniteteve rom dhe ashkali. Qëllimi i vizitave do të jetë ofrimi i shërbimeve shëndetësore për të gjithë nevojtarët, dhe në të njëjtën kohë edhe informimi i familjeve për rëndësinë e përkujdesjes ndaj shëndetit.</p>
<p>Aktiviteti 3.1.2 Identifikimi i fëmijëve të pa imunizuar dhe imunizimi i tyre</p>	<p>ZKKK në bashkëpunim me DSHMS bëjnë identifikimin e të gjithë fëmijëve që nuk iu kanë nënshtruar procesit të imunizimit.</p> <p>Pas identifikimit të tyre, përmes vizitave familjare, apo edhe përmes organizimit të vizitave kolektive në lokacione të caktuara, bëhet imunizimi i tyre.</p> <p>Ky aktivitet mund të organizohet në bashkëpunim me OJQ-të apo edhe me institucionet arsimore.</p>
REZULTATI 3.2:	Përmirësimi i shëndetit të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali, përmes ndërgjegjësimit dhe promovimit të shëndetit

AKTIVITETI	PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT
Aktiviteti 3.2.1 Organizimi i ligjëratave rreth edukimit shëndetësor dhe planifikimit familjar	<p>DSH në koordinim të ngushtë QKMF dhe QMF, duhet të organizojnë ligjëratat të strukturuar rreth edukimit shëndetësor për familjet e komuniteteve rom dhe ashkali.</p> <p>Vend të rëndësishëm gjatë këtyre ligjëratave duhet të zë edhe çështja e planifikimit familjar. Për të realizuar këto ligjëratat, DSH do të bashkëpunojë edhe me OJQ-të lokale që punojnë në këtë fushë, por edhe me udhëheqësit e lagjeve, përkatësisht përfaqësuesit e komunitetit.</p>
Aktiviteti 3.2.2 Organizimi i fushatave vetëdijësuese për shërbimet që ofrojnë QMF	<p>QKMF dhe QMF në bashkëpunim edhe me OSHC-të, duhet të organizojnë fushata vetëdijësuese, ku target do të jenë familjet nga komunitetet rom dhe ashkali, me qëllim të informimit të tyre për shërbimet që ofrohen në QMF.</p>
Aktiviteti 3.2.3 Organizimi i vizitave periodike për mamografi – në koordinim me ZKKK	<p>DSH në bashkëpunim me ZKKK dhe MSh/QKUK organizojnë vizita periodike për mamografi. Kjo mund të realizohet duke i organizuar këto vizita në QKMF apo edhe duke i organizuar vizitat në komunitet përmes Mamografit mobil që menaxhohet nga MSH-ja.</p>
REZULTATI 3.3:	Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore, përmes ndërgjegjësimit të stafit shëndetësor publik për trajtim të barabartë dhe eliminim të diskriminimit të komuniteteve rom dhe ashkali
AKTIVITETI	PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT
Aktiviteti 3.3.1 Organizimi i fushatave vetëdijësuese për ndërgjegjësimin e stafit shëndetësor për trajtim të barabartë të pacientëve	<p>DSH në koordinim të ngushtë me QKMF-në dhe QMF-të, duhet të organizojnë fushata vetëdijësuese për stafin shëndetësor që komunitetet rom dhe ashkali të trajtohen barabartë dhe pa asnjë diskriminim gjatë ofrimit të shërbimeve shëndetësore.</p>

3.3.3. Supozimet dhe rreziqet

Supozimet kryesore për të siguruar arritjen e Objektivit 3, të paraparë me këtë dokument, janë:

- Të gjitha palët e përfshira kanë vullnet dhe angazhohen për realizimin e aktiviteteve të parapara me këtë plan;
- Gatishmëria e familjeve për të vazhduar ciklin e imunizimit të fëmijëve.

Ndërkaq, faktorët që mund ta rrezikojnë arritjen e Objektivit 3, të paraparë me këtë dokument, janë:

- Mungesa e angazhimit dhe përkushtimit të palëve të përfshira për të marrë përgjegjësitë që dalin nga ky plan;
- Mosgatishmëria e stafit të QKMF/QMF për të zhvilluar vizitat në terren.

3.4. Banimi

Kthimi dhe riatdhesimi i familjeve nga komunitet rom dhe ashkali mund ta vështirësoj dhe thelloj problematikën e vendbanimeve. Migrimi i shumë familjeve në fillimin e vitit 2014, ku shumë familje kanë shitur shtëpitë e tyre për të kërkuar jetë më të mirë në vendet e perëndimit, e ka thelluar dukshëm mungesën e vendbanimeve, sidomos pas kthimit të tyre.

Për të adresuar sa më mirë këtë çështje, Komuna e Vushtrrisë duhet të ndërmarrë masa dhe veprime konkrete. Të gjitha këto masa dhe veprime janë përmbledhur në objektivin e katërt të këtij Plani.

Objektiva strategjike 4

Për të siguruar adresim të mirëfilltë të sfidave të renditura më lart në fushën e banimit, është përcaktuar ky objektivi strategjik:

Objektivi 4: Rritja e qasjes së barabartë në banim të qëndrueshëm, shërbime esenciale dhe infrastrukturë publike për komunitetet rom dhe ashkali.

3.4.1. Rezultatet e pritshme

Për përmbushjen e objektivit strategjik të përcaktuar në këtë Plan veprimi për fushën e banimit parashihet arritja e rezultateve të pritshme në vijim:

- **Rezultati 4.1.** Janë identifikuar nevojat e pjesëtarëve të komuniteteve për banim adekuat dhe banim social

3.4.2. Përshkrimi i aktiviteteve

REZULTATI 4.1:	Janë identifikuar nevojat e pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali për banim adekuat
AKTIVITETI	PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

Aktiviteti 4.1.1

Hartimi i databazës së familjeve të pastrehë / familjeve në nevojë për banim

ZKKK në bashkëpunim me Komitetin për Komunitete dhe në koordinim me përfaqësuesit e komuniteteve rom dhe ashkali, bënë identifikimin e të gjitha familjeve të pastrehë apo që kanë nevojë për banim.

Të dhënat e detajuara për secilën familje do të futen në një databazë, e cila do të shfrytëzohet edhe nga institucione tjera komunale. Hartimi i kësaj databaze duhet të jetë një proces i vazhdueshëm për shkak të lëvizjeve të mëdha që ndodhin, më konkretisht, për shkak të ndërrimit të vendbanimeve nga familjet, riatdhesimin e familjeve, apo për shkak të paraqitjes së rasteve të reja për banim.

3.4.3. Supozimet dhe rreziqet

Supozimet kryesore për të siguruar arritjen e Objektivit 4 të paraparë me këtë dokument, janë:

- Institucionet qendrore të Kosovës dhe donatorët ndërkombëtarë përkrahin Komunën e Vushtrrisë për ndërtimin / renovimin e shtëpive për familjet e pastreha të komuniteteve rom dhe ashkali, në përputhje me masat dhe aktivitetet e parapara në “Strategjinë për avancimin e komuniteteve rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës 2022 - 2026”.

Ndërkaq, faktorët që mund ta rrezikojnë arritjen e Objektivit 4, të paraparë me këtë dokument, janë:

- Mosndarja e buxhetit nga institucionet qendrore të Kosovës dhe nga donatorët, siç parashihet në “Strategjinë për avancimin e komuniteteve rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës 2022 - 2026”.

3.5. Diskriminimi

Diskriminimi në bazë të etnisë për komunitetet rom dhe ashkali është shkaktar i shumëfishtë i problemeve të këtyre komuniteteve dhe konsiderohet hendek kryesor i integritit të këtyre komuniteteve në shoqëri dhe ekonomi.

Për të adresuar sa më mirë këtë çështje, Komuna e Vushtrrisë duhet të ndërmarrë masa dhe veprime konkrete. Të gjitha këto masa dhe veprime janë përmbledhur në objektivin e katërt të këtij Plani.

Objektivi strategjik 5

Për të siguruar adresim të mirëfilltë të sfidave të renditura më lart në fushën e diskriminimit, është përcaktuar ky objektivi strategjik:

Objektivi 5: Parandalimi dhe luftimi i diskriminimit, gjuhës së urrejtjes, krimeve të urrejtjes, segregimit, paragjyqimeve, stereotipeve dhe bullizmit.

3.5.1. Rezultatet e pritshme

Për përmbushjen e objektivit strategjik të përcaktuar në këtë Plan veprimi për fushën e diskriminimit, parashihet arritja e rezultateve të pritshme në vijim:

- **Rezultati 5.1.**

3.5.2. Përshkrimi i aktiviteteve

REZULTATI 5.1:	Luftimi i diskriminimit dhe racizmit në mënyrë sistematike përmes zhvillimit dhe zbatimit të politikave gjithëpërfshirëse në të gjitha fazat dhe nivelet e politikave, programeve dhe projekteve
AKTIVITETI	PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT
<p>Aktiviteti 5.1.1 Promovimi i platformës nacionale për mbrojtje nga diskriminimi ndaj komuniteteve rom dhe ashkali</p>	<p>Platforma për raportimin e rasteve të diskriminimit është një platformë e cila ju mundeson komuniteteve rom dhe ashkali të raportojnë antigjipsizmin si: diskriminimin, segregimin, gjuhën e urrejtjes, krimet e urrejtjes, stereotipet, paragjykimet. Është një mjet që i shërben grupit teknik për mbrojtje nga diskriminimi, e themeluar nga ZK-ja, për të trajtuar ankesat/rastet e diskriminimit ndaj komuniteteve rom dhe ashkali.</p> <p>Komuna jone angazhohet ne promovimin e platformës përmes vendosjes së posterëve të platformës (me QR kod) në sportelet e Komunes, vendosja e linkut të platformës në ueb-faqen e Komunes, shpërndarja e broshurave informuese, si dhe promovimi i storjeve të suksesit. Gjithashtu, do të organizohen edhe sesione informuese mbi platformën dhe mënyrën e përdorimit të saj.</p>
<p>Aktiviteti 5.1.2 Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve publik për mos diskriminimin racor</p>	<p>Komuna e Vushtrrise në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Administratë Publike dhe Zyrën për Qeverisje të Mirë, do të hartohet një modul të trajnimit të trajnerëve për mos diskriminimin racor . Trajnerët e rinj do të trajnojnë zyrtarët publik nga gjithë Kosova, përfshirë zyrtarët publikë që punojnë në institucione të ndryshme në Komunën e Vushtrrisë.</p>
<p>Aktiviteti 5.1.3 Ngritja e kapaciteteve të mediave të gazetareve mos diskriminimin racor</p>	<p>Në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Administratë Publike dhe Zyrën për Qeverisje të Mirë, do të hartohet një modul i trajnimit të trajnerëve mos diskriminimin racor. Trajnerët do të trajnojnë gazetarët për mos diskriminimin racor dhe raportimin e përgjegjshëm etik.</p>

3.5.3. Supozimet dhe rreziqet

Supozimet kryesore për të siguruar arritjen e Objektivit 5, të paraparë me këtë dokument, janë:

- Të gjitha palët e përfshira kanë vullnet dhe angazhohen për realizimin e aktiviteteve të parapara me këtë dokument;
- Institucionet të tregojnë gatishmëri për të bashkëpunuar.

Ndërkaq, faktorët që mund ta rrezikojnë arritjen e Objektivit 5, të paraparë me këtë dokument, janë:

- Mungesa e angazhimit dhe përkushtimit të palëve të përfshira për të marrë përgjegjësi të që dalin nga ky Plan;
- Mungesa e bashkëpunimit nga vetë pjesëtarët e komuniteteve.

4. BUXHETI

Plani lokal i veprimit për avancimin e komuniteteve rom dhe ashkali në Komunën e Vushtrrisë 2024 - 2026”, parashihet që për periudhën trevjeçare të zbatimit të ketë një buxhet total prej 43,634.40 euro (€), prej të cilave 40,034.40 € parashihen të mbulohen nga buxheti i Komunës, ndërsa 3,600.00 € parashihen të mbulohen nga donatorët e ndryshëm.

Në vijim është buxheti i detajuar për 3 vite i këtij Plani të veprimit, i ndarë sipas fushave, sipas viteve dhe sipas burimeve të financimit (i shprehur në euro).

Fusha	Burimi i financimit	Viti			Total €
		2024	2025	2026	
1. Arsimi	Buxheti i Komunës	7,844.80	7,844.80	7,844.80	23,654.40
	Donatorët	400.00	500.00	500.00	1,400.00
	Total	8,244.80	8,344.80	8,344.80	25,054.40
2. Punësimi dhe mirëqenia	Buxheti i Komunës	5,500.00	5,500.00	5,500.00	16,500.00
	Donatorët	200.00	200.00	200.00	600.00
	Total	5,700.00	5,700.00	5,700.00	17,100.00
3. Shëndetësia	Buxheti i Komunës	0.00	0.00	0.00	0.00
	Donatorët	0.00	0.00	0.00	0.00

	Total	0.00	0.00	0.00	0.00
4. Banimi	Buxheti i Komunës	0.00	0.00	0.00	0.00
	Donatorët	0.00	0.00	0.00	0.00
	Total	0.00	0.00	0.00	0.00
5.Dsikriminimi	Buxheti i Komunës	0.00	0.00	0.00	0.00
	Donatorët	1,000.00	1,000.00	1,000.00	3,000.00
	Total	0.00	0.00	0.00	3,000.00
Totali i buxhetit për të gjitha fushat	Buxheti i Komunës	13,344.80	13,344.80	13,344.80	40,034.40
	Donatorët	1,200.00	1,200.00	1,200.00	3,600.00
	Total	14,544.80	14,544.80	14,544.80	43,634.40

Sic mund të shihet nga Plani i zbatimit, ku paraqitet buxheti i detajuar për secilin aktivitetet të paraparë në kuadër të këtij plani të veprimit, i ndarë sipas fushave, sipas viteve dhe sipas burimeve të financimit, i shprehur në euro, shumë aktivitete të këtij Plani nuk kanë kosto financiare, për arsye se ato zbatohen nga institucionet lokale, në kuadër të përgjegjësive të punës.

Po ashtu, në Plan nuk janë përfshirë aktivitete të cilat kanë filluar më herët dhe vazhdojnë të zbatohet nga Komuna, OSHC-të apo donatorët.

5. PLANI I ZBATIMIT

PLANI LOKAL I VEPRIMIT PËR AVANSIMIN E KOMUNITETEVE ROM DHE ASHKALI NË KOMUNËN E VUSHTRISË

			Periudha e implementimit		Institucioni/organizata mbështetëse	Përshkrimi i kostos	Burimi i financimit	2024	2025	2026	Totali
1.2.1	Organizimi i fushatave vetëdijësuese për regjistrim në edukimin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë	<p>ZKKK në bashkëpunim me DKA-në dhe shkollat ku frekuentojnë nxënësit nga komunitetet rom dhe ashkali, për çdo fillimvit shkollor organizon fushatë vetëdijësuese për regjistrim në edukimin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë të fëmijëve nga komunitetet rom dhe ashkali.</p> <p>Fushata vetëdijësuese përfshin organizimin e takimeve individuale me familjet e komuniteteve; shpërndarje të informatave për regjistrim. Fushatat organizohen nga shkollat, derisa ZKKK dhe DKA ofrojnë përkrahje për shkollat.</p>	2024 – 2026	DKA, ZKKK, shkollat	OJQ-të, Donatorët	Mbështetja financiare nga TDH për vitin 2024	TDH	/	/	/	-
1.2.2	Identifikimi i fëmijëve në nevojë dhe sigurimi i mjeteve arsimore	<p>ZKKK në bashkëpunim me DKA dhe QPS, bëjnë identifikimin e familjeve që kanë gjendje të rëndë ekonomike dhe që kanë fëmijë të moshës së arsimit të detyruar. Fëmijët e identifikuar duhet të pajisen me pako shkollore, së paku një herë në vit.</p> <p>Përveç përkrahjes me pako shkollore nga vet Komuna, institucionet përgjegjëse mund të kërkojë edhe ndihmën e donatorëve dhe të bizneseve private për t'i përkrahur këta nxënës me pako shkollore apo edhe me veshmbathje.</p>	2024 – 2026	DKA, ZKKK	DSHMS, QPS, Donatorët	Për çdo vit shpërndahen pako shkollore për nxënës	Komuna	1,964.8	1,964.8	1,964.8	7,859.2

1.2.2	Adresohen rastet e braktisjes dhe fëmijëve të ri-atdhesuar	<p>ZKKK në bashkëpunim me sektorët tjerë në nivel komune, identifikon të gjithë fëmijët që kanë braktisur shkollimin dhe familjet e ri-atdhesuara të cilat kanë fëmijë të moshës shkollore. Pas identifikimit, ZKKK ndërmerr të gjithë hapat për të adresuar në mënyrën më të mirë nevojat e këtyre familjeve.</p> <p>Në rastet e braktisjes, ZKKK dhe DKA aktivizojnë të gjithë mekanizmat për të siguruar vijimin e shkollimit nga nxënësit braktisës.</p> <p>Për rastet e fëmijëve të ri-atdhesuar, ZKKK krahas përkrahjes që ofron në kuadër të politikave të ri-atdhesimit, do të ofrojë edhe përkrahje shtesë për fëmijët e moshës shkollore, p.sh. përkrahje për t'u pajisur me dokumentacionin përkatës, përkrahje për të nostrifikuar dokumentet.</p>	2024 – 2026	ZKKK	DKA, OJQ-të dhe donatorët	Nuk ka kosto	/	/	/	/	-	
Nën-Totali 1.2									1,964.8	1,964.8	1,964.8	7,859.2

Rezultati 1.3 Përmirësohet performanca e nxënësve dhe studentëve të komuniteteve rom dhe ashkali

Kodi	Aktiviteti	Përshkrimi i Aktivitetit	Periodha e implementimit	Përgjegjësia	Institucioni/ organizata mbështetëse	Përshkrimi i kostos	Burimi i financimit	2024	2025	2026	Totali
1.3.1	Organizohet mësimi plotësues dhe shtesë për fëmijët e komuniteteve rom dhe ashkali	<p>DKA në bashkëpunim me ZKKK dhe OJQ-të, organizojnë mësim plotësues dhe shtesë për fëmijët nga komunitetet rom dhe ashkali që kanë rezultate të ulëta të të nxënësve. Bartës kryesor për organizimin e mësimit shtesë mund të jenë OJQ-të, derisa DKA, shkollat dhe ZKKK ofrojnë mbështetje organizative dhe në mobilizimin e donatorëve.</p> <p>Supozohet që në programin e mësimit plotësues dhe shtesë, do të përfshihen 50 fëmijë.</p>	2024 - 2026	DKA, ZKK, Shkollat	OJQ-të, Donatorët	7600 (+5200 shujta ditore per 100 femije)	TDH	/	/	/	-
1.3.2	Organizohet arsimimi joformal për fëmijët që kanë vonesa në shkollimin e obliguar	<p>DKA, ZKKK dhe shkollat, në bashkëpunim MASHT dhe OJQ-të, do të bëjnë identifikimin e të gjithë fëmijëve që kanë vonesa në shkollimin e obliguar. Duke u bazuar në gjendjen ekzistuese dhe në trendin e kthimit / riatdhesimit të familjeve nga vendet e ndryshme. Supozohet që brenda një viti shkollor rreth 10 fëmijë të komuniteteve rom dhe ashkali do të përfitojnë mësimi intensiv. Komuna e Vushtrrisë do të lirojë nga pagesa të gjithë nxënësit që do t'i nënshtrohen mësimit joformal.</p> <p>Arsimi joformal do të aplikohet gjatë viteve të zbatimit të këtij Plani të veprimit, me qëllim të përfshirjes së të gjithë fëmijëve. Megjithatë, do të maksimizohen mundësitë që rastet që kanë mundësi, të përfshihen në sistemin e rregullt shkollor.</p>	2024 - 2026	DKA, MASHT	OJQ-të, Donatorët	Komuna do të lirojë nga pagesa	Komuna	/	/	/	-

1.3.3	Organizimi i trajnimeve kundër diskriminimit dhe paragjyqimeve për mësimdhënës	DKA në bashkëpunim me donatorët dhe me OSHC-të që ofrojnë trajnime të kësaj natyre, organizojnë trajnime periodike kundër diskriminimit dhe paragjyqimeve për mësimdhënësit që punojnë me fëmijë të komuniteteve rom dhe ashkali. Trajnimet e tilla do t'i përgatisin mësimdhënësit që të krijojnë një ambient miqësor dhe përkrahës për të gjithë fëmijët në klasë, pa kurrfarë dallime. Po ashtu, këto trajnime do të ndihmojnë mësimdhënësit që të krijojnë klasa gjithëpërfshirëse, duke përmbytur nevojat e të gjithë nxënësve në klasë.	2024 - 2026	DKA, ZKKK	OJQ-të, Donatorët	1,400 € (ndërtimi i kapaciteteve në politika të mbrotjes së femijeve dhe menaxhimit të rasteve per femije ne konflikt me ligjin nën moshen e pergjegjesisë penale	TDH	/	/	/	1,400.00 €	
1.3.4	Monitorimi i suksesit dhe qëndrueshmëria e intervenimit	ZKKK në bashkëpunim me DKA dhe me shkollat monitorojnë suksesin e fëmijëve të komuniteteve rom dhe ashkali të cilët janë përfitues të skemave të ndryshme përkrahëse (përfituesit e bursave, përfituesit e pakove shkollore, përfituesit e mësimintenziv). Në baza vjetore hartohet një raport, i cili shpërndahet tek sektorët përgjegjës	2024 - 2026	ZKK, DKA	OJQ-të, Donatorët	S'ka kosto	/	/	/	/	-	
Nën – Totali 1.3									-	-	-	1,400.00 €
Totali i Objektivit 1:									7,844.80 €	7,844.80 €	7,844.80€	29,839.20 €

Fusha: PUNËSIMI DHE MIRËQENIA SOCIALE

Objektivi 2: Rritja e qasjes së barabartë në punësim të qëndrueshëm, si dhe ulja e varfërisë të komuniteteve rom dhe ashkali

Rezultati 2.1 Përmirësimi i qasjes në pjesëmarrje të barabartë në treg të punës përmes sistemit të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali në zyrat komunale për punësim dhe programeve të aftësimin profesional;											
Kodi	Aktiviteti	Përshkrimi i Aktivitetit	Periudha e implementimit	Përgjegjësia	Institucioni/organizata mbështetëse	Përshkrimi i kostos	Burimi i financimit	B U X H E T I (EURO)			
								2024	2025	2026	Totali
2.1.1	Identifikimi i fuqisë punëtore nga komunitetet rom dhe ashkali (i të papunëve dhe punëkërkuësve) dhe ofrimi i këshillave për punësim	ZKKK në bashkëpunim me Zyrën e Punësimin bënë identifikimin e fuqisë punëtore nga komunitetet rom dhe ashkali (i të papunëve dhe punëkërkuësve) dhe harton një databazë. Në bazë të nevojës harton plane përkrahëse këshilluese. ZKKK ndërmjetëson në raste të ndryshme me qëllim të rritjes së punësimin të përfaqësuesve të komuniteteve.	2024 -2026	ZKKK, Zyra e punësimin	OSHC-të, Donatorët	Nuk ka kosto	/	/	/	/	-
2.1.2	Ofrimi i trajnimeve profesionale nga QAP për punëkërkuësit	ZKKK në bashkëpunim me Zyrën e Punësimin dhe në koordinim të ngushtë me Qendrat për Aftësim Profesional, duke u bazuar në nevojat e punëkërkuësve nga komunitetet rom dhe ashkali, harton plane për përfshirjen në trajnime për aftësim profesional. Organizimi i trajnimeve mund të bëhet duke i përfshirë përfituesit potencialë në programe të ndryshme që janë duke u zbatuar nga USAID, GIZ etj. Supozohet që brenda një viti, mund të kemi 10 të interesuar për pjesëmarrje në programin e aftësimin profesional.	2024 - 2026	Komuna	OSHC-të, Donatorët	S'ka kosto	/	/	/	/	-

2.1.3	Monitorimi i rasteve të dhunës së grave dhe fëmijëve në familje, në strehimoren rehabilituese	ZKKK në bashkëpunim me Zyrën e Punësimit, OJQ-të monitorojnë dhe raportojnë në vazhdimësi tek autoritet për rastet e viktimave të dhunës në familje	2024 - 2026	Komuna	OJQ, Donatorët	S'ka kosto	/	/	/	/	-
2.1.4	Identifikimi i familjeve që janë në asistencë sociale, dhe familjeve të cenueshme, ofrimi i ndihmave me pako ushqimore, higjienike, dru zjarri dhe pako me dhurata	ZKKK në bashkëpunim me QPS-të do të bëjë identifikimin e familje me asistencë sociale, ZKKK do të shpërndajë pako me material ushqimore, higjienike dhe dru zjarri për këto familje	2024 - 2026	Komuna	Komuna	Shpërndarje e pakove ushqimore 6175 €, higjienike 2,480 €, dru zjarri rreth 30,000 € dhurata per fëmijë 1,250 €	Komuna	39,905.00 €	39,905.00 €	39,905.00 €	159,620.00 €
Nën-Totali 2.1								39,905.00 €	39,905.00 €	39,905.00 €	159,620.00 €

Rezultati 2.2 Rritja e pjesëmarrjes dhe mundësi në punësim përmes senzibilizimit të punëdhënësve dhe pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali, si dhe masave stimuluese për punëdhënës

Kodi	Aktiviteti	Përshkrimi i Aktivitetit	Periudha e implementimit	Përgjegjësia	Institucioni/organizata mbështetëse	Përshkrimi i kostos	Burimi i financimit				
								2024	2025	2026	Totali

2.2.1	Subvencionimi i bizneseve private për stimulim të punësimit të komuniteteve	<p>ZKKK në bashkëpunim me Zyrën e Punësimit, identifikon bizneset private që janë duke kërkuar fuqi punëtore. Në bashkëpunim me secilin biznes (aty ku ka gatishmëri dhe interesim) hartohet plani për punësimin e punëkërkuës nga komunitetet. Ky plan parasheh edhe subvencionimin nga ana e Komunës / ZKKK për biznesin.</p> <p>ZKKK duhet të luaj rol koordinues në zbatimin e këtij aktiviteti përmes bashkërendimit të punëve me të gjitha drejtoritë përkatëse të Komunës, ZQM, ministritë e linjës dhe komunitetin e donatorëve.</p>	2024 - 2026	ZKKK, DShMS	QPS, OShC-të, Donatorët	S'ka kosto	/	/	/	/	-
2.2.2	Parandalimi i punëve të rënda dhe mbrojtja e fëmijëve të komuniteteve rom dhe ashkali	<p>Rastet e shumta të shfrytëzimit të fëmijëve, qoftë për punë të rënda apo edhe shfrytëzimit të tyre për të kërkuar lëmoshë, obligojnë institucionet lokale që të zbatojnë masa për parandalimin e keqpërdorimit të fëmijëve.</p> <p>ZKKK do të ketë rol monitorues dhe mobilizues për të njoftuar institucionet dhe mekanizmat tjerë, në mënyrë që të parandalohet çdo keqpërdorim i fëmijëve të komuniteteve qoftë nga familja, apo grupet tjera të interesit.</p>	2024 - 2026	ZKKK, DShMS	OShC-të, Donatorët	4,350 (Aktivitete e kampanja vetedijesuese per rreziqet e fëmijeve nga punët e rënda, kerkim lëmosha në rrugë.	TDH	/	/	/	4,350.00 €

2.2.3	Koordinim i shtuar në mes sektorëve komunalë për të avancuar qasjen e pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali në punësim dhe shërbime sociale	ZKKK do të themelojë një mekanizëm komunal ndërsektoral, që do të ketë për mandat koordinimin e të gjithë aktorëve për të avancuar qasjen e pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali në punësim dhe shërbime sociale. Në këtë mekanizëm do të bëjnë pjesë: ZKKK (koordinator), DSHMS, QPS, Zyra e punësimin, DKA, OJQ-të, bizneset etj. Varësisht nga nevojat, ky mekanizëm mund të zgjerohet edhe me përfaqësues nga palët me interes.	2024 - 2026	ZKKK	DSHMS, QPS, DKA, Zyra e Punësimin, OShC-të, Donatorët	Nuk ka kosto	/	/	/	/	-
2.2.4	Organizim i takimeve periodike për koordinim në mes të sektorëve	ZKKK si koordinator e Grupit koordinues do të organizojë takime periodike për të siguruar që janë ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të avancuar qasjen e pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali në punësim dhe shërbime sociale.	2024 - 2026	ZKKK	DSHMS, QPS, DKA, Zyra e Punësimin, OShC-të, Donatorët	Nuk ka kosto	/	/	/	/	-
Nën-Totali 2.2								/	/	/	4,350.00 €

Rezultati 2.3 Përfshirja e komuniteteve rom dhe ashkali në punësim në institucione publike qendrore dhe lokale, sipas kuotave të përcaktuara nga ligji

Kodi	Aktiviteti	Përshkrimi i aktivitetit	Periudha e implementimit	Përgjegjësia	Institucioni/ organizata mbështetëse	Përshkrimi i kostos	Burimi i financimit				
								2024	2025	2026	Totali

2.2.5	Fushatë informuese dhe avokuese për respektim të kuotës së punësimit për komunitetet	<p>ZKKK në bashkëpunim me Zyrën e Punësimit si dhe me përkrahjen e OSHC-ve dhe donatorëve të ndryshëm, organizojnë fushatë avokuese në nivel komunal, për të avancuar zbatimin e kuotës së punësimit për komunitetet rom dhe ashkali.</p> <p>Kjo fushatë do të koordinohet nga ZKKK dhe ka për qëllim informimin e të gjitha institucioneve në nivel komune, bizneseve, punëdhënësve potencialë, por edhe publikut në përgjithësi, për kuotat e përcaktuara me ligj për punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve.</p>	2018 – 2019	ZKKK, DShMS	QPS, OSHC-të, Donatorët	Nuk ka kosto	/	/	/	/	-	
Nën-Totali 2.2									-	-	-	-

Totali i				
Objektivit	39.905.00€	39.905.00€	39.905.00€	163,970.00€
2:				

Fusha: SHËNDETËSIA

Objektivi 3: Përmirësimi i shëndetit të pjesëtarëve të komunitetet rom dhe ashkali dhe rritja e qasjes së barabartë në shërbime cilësore shëndetësore

Rezultati 3.1 Përmirësohet qasja në shërbime shëndetësore cilësore për komunitetet rom dhe ashkali

Kodi	Aktiviteti	Përshkrimi i aktivitetit	Periudha e implementimit	Përgjegjësia	Institucioni/ organizata mbështetëse	Përshkrimi i kostos	Burimi i financimit	B U X H E T I (EURO)			
								2024	2025	2026	Totali
3.1.1	Organizimi i vizitave periodike shëndetësore në familjet e komuniteteve nga QKMF	Rritja e besueshmërisë së familjeve të komuniteteve, veçmas fëmijëve, në raport me institucionet shëndetësore dhe familjarizimi me to, do të ndikonte në ngritjen e vetëdijes së pjesëtarëve të komuniteteve për të shfrytëzuar këto shërbime. QKMF me përkrahjen e DSH, DMS dhe ZKKK, organizon vizita periodike në familjet e komuniteteve rom dhe ashkali. Qëllimi i vizitave do të jetë ofrimi i shërbimeve shëndetësore për të gjithë nevojtarët, dhe në të njëjtën kohë edhe informimi i familjeve për rëndësinë e përkujdesjes ndaj shëndetit.	2024 - 2026	QKMF / QMF	DSH, DMS, ZKKK	Nuk ka kosto	/	/	/	/	-
3.1.2	Identifikimi i fëmijëve të paimunizuar dhe imunizimi i tyre	ZKKK në bashkëpunim me DSH, DMS bëjnë identifikimin e të gjithë fëmijëve që nuk iu kanë nënshtruar procesit të imunizimit. Pas identifikimit të tyre, përmes vizitave familjare, apo edhe përmes organizimit të vizitave kolektive në lokacione të caktuara, bëhet imunizimi i tyre. Ky aktivitet mund të organizohet në bashkëpunim me OJQ-të apo edhe me institucionet arsimore.	2024 - 2026	ZKKK, DSH, QKMF / QMF	OJQ-të, shkollat	Nuk ka kosto	/	/	/	/	-
Nën-Totali 3.1								-	-	-	-

Rezultati 3.2 Përmirësimi i shëndetit të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali, përmes ndërgjegjësimit dhe promovimit të shëndetit.											
Kodi	Aktiviteti	Përshkrimi i aktivitetit	Periodha e implementimit	Përgjegjësia	Institucioni/organizata mbështetëse	Përshkrimi i kostos	Burimi i financimit	2024	2025	2026	Totali
3.2.1	Organizimi i ligjëratave rreth edukimit shëndetësor dhe planifikimit familjar	DSH në koordinim të ngushtë QKMF dhe QMF-të, duhet të organizojnë ligjëratat të strukturuar rreth edukimit shëndetësor për familjet e komuniteteve rom dhe ashkali. Vend të rëndësishëm gjatë këtyre ligjëratave duhet të zë edhe çështja e planifikimit familjar. Për të realizuar këto ligjëratat, DSH do të bashkëpunojë edhe me OJQ lokale që punojnë në këtë fushë, por edhe me udhëheqësit e lagjeve, përkatësisht përfaqësuesit e komunitetit.	2024 - 2026	DSH, QKMF / QMF, ZKKK, ZBGJ	OJQ-të dhe donatorët	Nuk ka kosto	/	/	/	/	-
3.2.2	Organizimi i fushatave vetëdijësuese për shërbimet që ofrojnë QMF	QKMF dhe QMF-të në bashkëpunim edhe me OSHC-të, duhet të organizojnë fushata vetëdijësuese, ku target do të jenë familjet nga komunitetet rom dhe ashkali, me qëllim të informimit të tyre për shërbimet që ofrohen në QMF.	2024 - 2026	DSH, QKMF / QMF, ZKKK	OJQ-të dhe donatorët	Nuk ka kosto	/	/	/	/	-
3.2.3	Organizimi i vizitave periodike për mamografi – në koordinim me ZKKK	DSH në bashkëpunim me ZKKK dhe MSH/QKUK, organizojnë vizita periodike për mamografi. Kjo mund të realizohet duke i organizuar këto vizita në QKMF apo edhe duke i organizuar vizitat në komunitet përmes Mamografit mobil që menaxhohet nga MSH.	2024 - 2026	ZKKK, DSH, Zbgj	MSH	Nuk ka kosto	/	/	/	/	-
Nën-Totali 3.2							-	-	-	-	-

Rezultati 3.3 Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore, përmes ndërgjegjësimit të stafit shëndetësor publik për trajtim të barabartë dhe eliminim të diskriminimit të komuniteteve rom dhe ashkali

Kodi	Aktiviteti	Përshkrimi i aktivitetit	Periudha e implementimit	Përgjegjësia	Institucioni/organizata mbështetëse	Përshkrimi i kostos	Burimi i financimit	2024	2025	2026	Totali
3.3.1	Organizimi i fushatave vetëdijësuese për ndërgjegjësimin e stafit shëndetësor për trajtim të barabartë të pacientëve	DSH në koordinim të ngushtë me QKMF dhe QMF-të, duhet të organizojnë fushata vetëdijësuese për stafin shëndetësor që komunitetet rom dhe ashkali të trajtohen barabartë dhe pa asnjë diskriminim gjatë ofrimit të shërbimeve shëndetësore.	2024 - 2026	DSH, QKMF / QMF, ZKKK	OJQ-të dhe donatorët	TDH Trajnim mbi antigjipizmin	/	/	/	/	-
Nën-Totali 3.3							-	-	-	-	-
Totali i Objektivit 3:											- - - - -

Fusha: BANIMI

Objektivi 4: Rritja e qasjes së barabartë në banim të qëndrueshëm, shërbime esenciale dhe infrastrukturë publike për komunitetet rom dhe ashkali.

Rezultati 4.1 Janë identifikuar nevojat e pjesëtarëve të komuniteteve për banim adekuat dhe banim social

Kodi	Aktiviteti	Përshkrimi i aktivitetit	Periodha e implementimit	Përgjegjësia	Institucioni/organizata mbështetëse	Përshkrimi i kostos	Burimi i financimit	B U X H E T I (EURO)			
								2024	2025	2026	Totali
4.1.1	Hartimi i databazës së familjeve të pastrehë / familjeve në nevojë për banim	ZKKK në bashkëpunim me Komitetin për Komunitete dhe në koordinim me përfaqësuesit e komuniteteve rom dhe ashkali, bënë identifikimin e të gjitha familjeve të pastrehë apo që kanë nevojë për banim. Të dhënat e detajuara për secilën familje do të futen në një databazë, e cila do të shfrytëzohet edhe nga institucione tjera komunale. Hartimi i kësaj databaze duhet të jetë një proces i vazhdueshëm për shkak të lëvizjeve të mëdha që ndodhin, më konkretisht, për shkak të ndërrimit të vendbanimeve nga familjet, riatdhesimin e familjeve, apo për shkak të paraqitjes së rasteve të reja për banim.	2024	ZKKK	DSHMS, OJQ, Urbanizmi	Nuk kosto	/	/	/	/	-
Nën-Totali 4.1											-
Totali i Objektivit 4:							-	-	-	-	-

Fusha: **DISKRIMINIMI**

Objektivi 5: **Parandalimi dhe luftimi i diskriminimit, gjuhës së urrejtjes, krimeve të urrejtjes, segregimit, paragjykimeve, stereotipeve dhe bullizmit**

Rezultati 5.1: **Luftimi i diskriminimit dhe racizmit në mënyrë sistematike përmes zhvillimit dhe zbatimit të politikave gjithëpërfshirëse në të gjitha fazat dhe nivelet e politikave, programeve dhe projekteve**

Kodi	Aktiviteti	Përshkrimi i aktivitetit	Periodha e implementimit	Përgjegjësia	Institucioni/organizata mbështetëse	Përshkrimi i kostos	Burimi i financimit	B U X H E T I (EURO)			
								2024	2025	2026	Totali

5.1.1	<p>Promovimi i platformës nacionale për mbrojtje nga diskriminimi ndaj komuniteteve Rom dhe ashkali.</p>	<p>Platforma për raportimin e rasteve të diskriminimit është një platformë e cila iu mundeson komuniteteve rom dhe ashkali të raportojnë antigjipsizmin, si: diskriminimin, segregimin, gjuhën e urrejtjes, krimet e urrejtjes, stereotipet, paragjykimet. shte nje mjet qe i sherbet grupit teknik per mbrojtje nga diskriminimi e themeluar nga ZK, për të trajtuar ankesat/rastet e diskriminimit ndaj komuniteteve rom dhe ashkali. Zyra për Qeverisje të Mirë në bashkëpunim me “Terre Des Hommes” vazhdimisht promovon platformën. Aktivitet që do të implementohen me komunën janë: promovimi i platformës përmes vendosjes së posterëve të platformës (me QR kod) në sportelet e Komunes, vendosja e linkut të platformës në ueb-faqen e Komunës, shpërndarja e broshurave informuese, si dhe promovimi i storjeve të suksesit. Gjithashtu, do të organizohen edhe sesione informuese mbi platformën dhe mënyrën e përdorimit të saj.</p>	2024	ZQM, Njësi komunal për të drejtat e njeriut	OJQ, donatorë	Promovimi I platformës	TDH	-	-	-	1,000.00 €
5.1.2	<p>Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve publikë mbi antigjipsizmin në Kosovë.</p>	<p>Në bashkëpunim me Institutin e Kosoves për Administratë Publike dhe Zyrën për Qeverisje të Mirë, do të hartohet një modul i trajnimit të trajnerëve</p>	2024 – 2026	IKAP, ZQM	OJQ, Donatorë	Trajnim	TDH	-	-	-	3,000.00 €

		mbi antigjipsizmin në Kosovë. Trajnerët e rinj do të trajnojnë zyrtarët publikë nga gjithë Kosova, përfshirë zyrtarët publikë që punojnë në institucione të ndryshme në komunën e Vushtrrisë										
5.1.3	Ngritja e kapaacitetve të medieve të gazetareve mbi antigjipsizmin dhe raportimin e përgjegjshëm dhe etik	Në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Administratë Publike dhe Zyrën për Qeverisje të Mirë do të hartohet një modul i trajnimit të trajnerëve mbi antigjipsizmin për Kosovë. Trajnerët do të trajnojnë gazetarët për antigjipsizmin dhe raportimin e përgjegjshëm etik.	2024 – 2026	IKAP, ZQM	OJQ, Donatorë	Trajnim	TDH	-	-	-	5,000.00 €	
Nën-Totali 5.1								-	-	-	9,000.00 €	
								Totali i Objektivit 5:				9,000.00 €
								9,000.00 €	-	-	-	9,000.00 €

Kryesuesja e Kuvendit

Melihate Basholli-Latifi

